

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data 24.08.2021]

Për: Subjektin “PASTRIME SILVIO“ sh.p.k”

Adresa: Rruga “Fatmir Haxhiu” (prapa ETC),

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-76509-10-23-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Dezifektim të ambjenteve të përbashkëta të brendshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve” me fond limit prej: 8,000,000 leke pa TVSH.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur oferta në mënyrë elektronike, 6 (gjashtë) operatorë ekonomikë, si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik “Akademia e Shendetit Publik” sh.p.k. me NIPT – L32402038K me ofertë ekonomike në vlerën: 7,487,500 lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “FLORFARMA sh.p.k. meNIPT-K21405001N i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3. Operatori ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k. me NIPT –K61516506H me ofertë ekonomike në vlerën: 7,307,800 lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “NRG” sh.p.k. me NIPT- L13426006B me ofertë ekonomike 3,689,840 lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. me NIPT-K91413010N me oferte ekonomike 4,114,950 lekë pa TVSH.
6. Operatori ekonomik “Alpest” i cili nuk ka paraqitur dokumentacion

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k. me NIPT – L32402038K me ofertë ekonomike në vlerën: 7,487,500 lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “FLORFARMA sh.p.k. meNIPT-K21405001N i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3. Operatori ekonomik “NRG” sh.p.k. me NIPT- L13426006B me ofertë ekonomike 3,689,840 lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “Alpest” i cili nuk ka paraqitur dokumentacion

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik Akademia e Shëndetit Publik

1. Referuar arsyes se parë të skualifikimit të operatorit “**Akademia e Shëndetit Publik**” shpk për mungesën e certifikatës ISO 18001 të përkthyer e të noterizuar
2. Referuar arsyes së dytë të skualifikimit të operatorit “**Akademia e Shëndetit Publik**” shpk për aktin higjeno sanitar i cili nuk ka automjetin të cilësuar në këtë akt, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 3 përcaktohet ndër të tjera që operatori ekonomik duhet të paraqesi aktin e miratimit higjeno sanitar për magazinën/ vendruajtjen e preparative DDD dhe **për të paktën një automjet.**
3. Referuar arsyes së tretë të skualifikimit të operatorit **Akademia e Shëndetit Publik** për mungesën e mjekut me kohë të plotë,
4. Referuar arsyes së katërt të skualifikimit të operatorit Akademia e Shëndetit publik e për mungesën e firmës dhe vulës në kontratën e punës së inxhinierit kimist,
5. Referuar arsyes së pestë të skualifikimit të operatorit Akademia e Shëndetit publik e për mungesën e kontratave të punonjësve,
6. Referuar arsyes së gjashtë të skualifikimit të operatorit Akademia e Shëndetit Publik sh.p.k e për mungesën e kontratave të ngjashme me institucione shtetërore.

Operatori ekonomik NRG sh.p.k

- 1- Mjeku nuk është me kohë të plote,deklaruar në tetor
- 2- Punonjesit kanë mosperputhje të kontratave me listpagesat

**Mbi Shqyrtimin E Plotësimeve Për Kërkesen Ankimore Të Datës 23.02.2021 Nga
Operatori Ekonomik, Shoqëria “Alpen Pulito” Sh.P.K**

Sot, më datën 02.03.2021 Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, ngritur me Vendimin nr.1113/1 prot., datë 24.02.2021, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor,

Pasi shqyrtuam paraprakisht ankesën e paraqitur nga shoqëria “**Alpen Pulito**” shpk në lidhje me ankesën e paraqitur për skualifikimin e operatorit ekonomik nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për tenderin me objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë, zhvilluar me dt.10.02.2021, si dhe materialin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me anë të procesverbalit “Për shqyrtimin, vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave të procedurës së prokurimit publik” dt. 16.02.2021 për procedurën e prokurimit objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë, ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k.

Ankuesi ka marrë dijeni në datën 17.02.2021 për arsyet e skualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë dhe në dt. 22.02.2021 ka përpiluar ankesën, e cila është protokolluar në Fond në dt.23.02.2021.

Ankesa është paraqitur brenda afateve ligjore që parashikon neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

ARSYETIMI

Përpara se të trajtojmë pretendimet e ankuesit të ngritura në ankesë, duhet patur në konsideratë neni 63, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit është parashikuar:

1.“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

.....

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktos i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Në rastin konkret, sipas dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, rezulton se kërkesa e operatorit “**Alpen Pulito**” shpk mban datën 22.02.2021, protokolluar pranë AK me nr. 1118 dt 23.02.2021 dhe si e tille merret në shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave..

1. Referuar arsyes se parë të skualifikimit të operatorit “**Alpen Pulito**” shpk për mungesën e vërtetimi për detyrimet e shlyera të sigurimeve shoqërore, komisioni i shqyrtimit të ankesave pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik dhe kritereve të përcaktuara në DST konstatoi se paraqitja e vërtetimit për detyrimet e shlyera të sigurimeve shoqërore nuk është kërkuar në to. Në vlerësimin e një oferte të vlefshme, autoriteti kontraktor i përmbahet verifikimit të dokumentacionit të kërkuar në DST. Për sa më sipër pretendimi i shoqërisë “**Alpen Pulito**” shpk qëndron dhe si i tillë duhet pranuar.

2. Referuar arsyes së dytë të skualifikimit të operatorit “**Alpen Pulito**” shpk për mungesën e certifikatave Iso të noterizuara, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator konstaton se certifikatat ISO të kërkuara në DST, janë paraqitur nga ky operator ekonomik në formën origjinale të tyre. Në dokumentat standarte të tenderit përcaktohet: “ Të gjithë dokumentat e tenderit duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre”. Paraqitja e certifikimeve Iso në formën e tyre origjinale plotëson kriteret e përcaktuara. Për sa më sipër pretendimi i shoqërisë “**Alpen Pulito**” shpk qëndron dhe si i tillë duhet pranuar.

3. Referuar arsyes së tretë të skualifikimit të operatorit “**Alpen Pulito**”shpk, për mopërputhje të kontratës së punës së mjekut Gj.M me listëpagesat e shoqërisë, Komiteti i Shqyrtimit të Ankesave konstatoj se kontrata e punës me mjekun Gj. M është lidhur në 03.10.2016, me një afat 10 vjeçar. Paga e punonjësve mund të jetë objekt rishikimi gjatë vazhdimësisë së marrëdhënies së punës. Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në DST, mjeku duhet të jetë i përfshirë në listëpagesat e shoqërisë dhe të paraqitet CV, licenca, diploma dhe kontrata e punës me kohe të plotë dhe certifikata trajnimesh. Operatori ekonomik i është përmbajtur kritereve të përcaktuara dhe si i tillë pretendimi i ankuesit qëndron dhe kjo pikë e ankesës pranohet.

4. Referuar arsyes së katërt të skualifikimit të operatorit “**Alpen Pulito**”shpk për mopërputhje të kontratës së punës së inxhinierit kimist A.P me listëpagesat e shoqërisë, Komiteti i Shqyrtimit të Ankesave konstatoj se kontrata e punës me inxhinierin kimist A.P është lidhur në 03.10.2016, me një afat 10 vjeçar. Paga e punonjësve mund të jetë objekt rishikimi gjatë vazhdimësisë së marrëdhënies së punës. Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në DST, inxhinieri kimist duhet të jetë i përfshirë në listëpagesat e shoqërisë dhe të paraqitet CV, licenca, diploma dhe kontrata e punës me kohe të plotë dhe certifikata trajnimesh .Operatori ekonomik i është përmbajtur kritereve të përcaktuara dhe si i tillë pretendimi i ankuesit qëndron dhe kjo pikë e ankesës pranohet.

Mbi Shqyrtimin E Plotësimeve Për Kërkesen Ankimore Të Datës 23.02.2021 Nga Operatori Ekonomik, Shoqëria “Akademia E Shëndetit Publik”

Sot, më datën 02.03.2021 Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, ngritur me Vendimin nr.1113/1 prot., datë 24.02.2021, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor,

Pasi shqyrtuam paraprakisht ankesën e paraqitur nga shoqëria “**Akademia e Shëndetit Publik**” në lidhje me ankesën e paraqitur për skualifikimin e operatorit ekonomik nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për tenderin me objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të

përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë, zhvilluar me dt.10.02.2021, si dhe materialin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit,

VËREN:

Rrethanat e faktit:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me anë të procesverbalit “Për shqyrtimin, vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave të procedurës së prokurimit publik” dt. 16.02.2021 për procedurën e prokurimit objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë, ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik”.

Ankuesi ka marrë dijeni në datën 17.02.2021 për arsyet e skualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë dhe në dt. 23.02.2021 ka përpiluar ankesën, e cila është protokolluar në Fond në dt.23.02.2021.

Ankesa është paraqitur brenda afateve ligjore që parashikon neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

ARSYETIMI

Përpara se të trajtojmë pretendimet e ankuesit të ngritura në ankesë, duhet patur në konsideratë neni 63, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit është parashikuar:

2. “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

.....

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontrakto i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Në rastin konkret, sipas dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, rezulton se kërkesa e operatorit “**Akademia e Shëndetit Publik**” mban datën 23.02.2021, protokolluar pranë AK me nr. 1139 dt 23.02.2021 dhe si e tille merret në shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave..

1. Referuar arsyes se parë të skualifikimit të operatorit “**Akademia e Shëndetit Publik**” shpk për mungesën e certifikatës ISO 18001 të përkthyer e të noterizuar ,komisioni i shqyrtimit të

ankesave pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik dhe kriterëve të përcaktuara në DST konstatoi se OE ka paraqitur certifikatën ISO 45001 origjinale, e cila është ekuivalente me ISO 18001. Paraqitja e certifikimeve Iso në formën e tyre origjinale plotëson kriteret e përcaktuara dhe si e tillë kjo pikë e ankesës pranohet.

2. Referuar arsyes së dytë të skualifikimit të operatorit **“Akademia e Shëndetit Publik”** shpk për aktin higjensan i cili nuk ka automjetin të cilësuar në këtë akt, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 3 përcaktohet ndër të tjera që operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e miratimit higjensan për magazinën/ vendruajtjen e preparative DDD dhe **për të paktën një automjet**. Mbas vlerësimit të dokumentacionit të OE, konstatojmë se në aktin higjensan të paraqitur, nuk është i përfshirë automjeti i transportit. Operatori ekonomik duhet të plotësojë të gjithë kriteret e përcaktuara në DST, në mënyrë që oferta e paraqitur të klasifikohet si e vlefshme. Mungesa e plotësimit të një kriteri përbën kusht për skualifikimin e tij. Për sa më sipër kjo pikë e ankesës nuk qëndron dhe si e tillë nuk pranohet.

3. Referuar arsyes së tretë të skualifikimit të operatorit **Akademia e Shëndetit Publik** për mungesën e mjekut me kohë të plotë, komiteti i Shqyrtimit të Ankesave konstatoj se operatori ekonomik nuk e ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për mjekun, sipas kriterëve të përcaktuara, për sa më sipër kjo pikë e ankesës nuk qëndron.

4. Referuar arsyes së katërt të skualifikimit të operatorit Akademia e Shëndetit publik e për mungesën e firmës dhe vulës në kontratën e punës së inxhinierit kimist, KSHA vlerësoj që kontrata është e panënshkruar dhe si e tillë nuk plotëson formën ligjore. Për sa më sipër kjo pikë e ankesës nuk qëndron.

5. Referuar arsyes së pestë të skualifikimit të operatorit Akademia e Shëndetit publik e për mungesën e kontratave të punonjësve, Komiteti i Shqyrtimit të Ankesave pasi vlerësoi dokumentacionin, konstatoj se ato nuk ishin paraqitur në tender. Paraqitja e tyre është kriter kualifikues dhe si e tillë kjo pikë e ankesës nuk qëndron.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik, u konstatua gjithashtu se nuk ishin paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, nuk plotësohet nr. i punonjësve të kërkuar (20 punonjës) për periudhën Korrik- Shtator 2020.

Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti të vetëm konsiderohen si kushte për skualifikim.

Mbi Shqyrtimin E Plotësimeve Për Kërkesen Ankimore Të Datës 22.02.2021 Nga Operatori Ekonomik, Shoqëria “Pastrime Silvio” Sh.P.K

Sot, më datën 01.03.2021 Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, ngritur me Vendimin nr.1113/1 prot., datë 24.02.2021, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor,

Pasi shqyrtuam paraprakisht ankesën e paraqitur nga shoqëria **“Pastrime Silvio” shpk** në lidhje me ankesën e paraqitur për skualifikimin e operatorit ekonomik nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për tenderin me objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të

brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë, zhvilluar me dt.10.02.2021, si dhe materialin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit,

VËREN:

Rrethanat e faktit:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me anë të procesverbalit “Për shqyrtimin, vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave të procedurës së prokurimit publik” dt. 16.02.2021 për procedurën e prokurimit objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë, ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Sivio” sh.p.k.

Ankuesi ka marrë dijeni në datën 17.02.2021 për arsyet e skualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Dezinfektim të ambjenteve të përbashkëta të brendëshme të Fondit, të Drejtorive Rajonale dhe Degëve”, me fond limit 8.000.000 (tetë milion) lekë dhe në dt. 19.02.2021 ka përpiluar ankesën, e cila është protokolluar në Fond në dt.22.02.2021.

Ankesa është paraqitur brenda afateve ligjore që parashikon neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

ARSYETIMI

Përpara se të trajtojmë pretendimet e ankuesit të ngritura në ankesë, duhet patur në konsideratë neni 63, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit është parashikuar:

3.“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

.....

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim,autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar,sipas këtij ligji.

Në rastin konkret, sipas dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, rezulton se kërkesa e operatorit “Pastrime Sivio” shpk është paraqitur në datën 19.02.2021, protokolluar pranë AK me nr. 1113 dt 22.02.2021 dhe si e tille merret në shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave..

1. Referuar arsyes se parë të skualifikimit të operatorit “Pastrime Sivio” shpk për mospërputhje të kontratës së punës së punonjësve me listëpagesën e shoqërisë, pas shqyrtimit të

dokumentacionit të paraqitur nga operatori, u konstatua se kontratat e lidhur me punonjësit e kësaj kompanie janë pa afat. Paga e punonjësve mund të jetë objekt rishikimi gjatë vazhdimësisë së marrëdhënies së punës. Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në DST, këta punonjës duhet të jenë përfshirë në listëpagesat e shoqërisë dhe të zotërojnë kualifikimet e kërkuara. Operatori ekonomik i është përmbajtur kritereve të përcaktuara dhe si i tillë pretendimi i ankuesit qëndron.

2. Referuar arsyes së dytë të skualifikimit të operatorit “Pastrime Silvio” shpk . Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se element i pagës së punonjësit përcaktohet me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ndalet në vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori. Nga vlerësimi i tij konstatojmë që dokumentacioni i mjekut është në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST dhe si e tillë, kjo pikë e ankesës pranohet.

3. Referuar arsyes së tretë të skualifikimit të operatorit “Pastrime Silvio” shpk konstatojmë që kjo arsye nuk qëndron, pasi nga dokumentacioni i paraqitur vërtetohet që mjeku J.P është i specializuar si mjek epidemiolog. Gjithashtu për sa i përket inxhinierit kimist nga vlerësimi i dokumentacionit konstatojmë se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST dhe si e tillë kjo pikë e ankesës pranohet.

4. Referuar arsyes së tretë të skualifikimit të operatorit “Pastrime Silvio” shpk për paisjen me certifikatë ISO 18001, konstatojmë se OE ka paraqitur certifikatën ISO 45001, e cila është ekuivalente me ISO 18001 dhe si e tillë kjo pikë e ankesës pranohet.

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë, 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Komisioni I Vlerësimit të ofertave realizoi fazën e rivlerësimit të procedurës nga I cili janë kualifikuar operatorët ekonomik “ALPEN PULITO” dhe “PASTRIME SILVIO”

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe ofertave rezultoi se operatori ekonomik “Pastrime SILVIO” me oferte ekonomike 4.114,950 leke pa TVSH sipas formules se perlllogaritur kjo oferte rezulton oferte anomalisht e ulet.

Per kete arsye ne zbatim te nenit 56 te ligjit 9643 date 20.11.2006 “Per prokurimin public” si dhe te nenit 66pika 5 te VKM Nr.914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public” KVO I ka derguar mesazh elektronik ne sistemin e APP-se operatorit duke I kerkuar argumentimin me shkrim per elemente te vecante te ofertes si argumentimin ekonomik,argumentimin teknik cilesine e produkteve,referencat doganore per artikujt object prokurimi te pasqyruara dhe ne bilancin e shoqerise.Dokumentacioni I paraqitur nga operatori te mos jete ne forme declarative,port e jete dokumentacion qe te vertetoje kryerjen e transaksioneve dhe te jete I gjurmueshem ne sistemin tatimore ose doganorapo ndonje kusht tjeter favorizues .Argumentimi duhet te dergohet ne forme elektronike dhe me shkrim zyrtarisht.

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” paraqiti ne menyre zyrtare me Nr.1113/4 prot date 03.03.2021 argumentimin e tij ne lidhje me oferten sipas kerkeses se autoritetit kontraktore dhe KVO pas shqyrtimit te materjalit argumentues nga ana e operatorit ekonomik e gjeti kete materjal

te drejte dhe te mbeshtetur ne argumenta ekonomik dhe teknik dhe per pasoje vazhdoj vleresimin duke nxjer ne rezultatin final si fitues operatorin ekonomik "Pastrime Silvio me NIPT K91413010N me oferte ekonomike 4,114.950 leke pa TVSH.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Subjektin "PASTRIME SILVIO" sh.p.k" Adresa: Rruga "Fatmir Haxhiu" (prapa ETC), se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4,114,950 (kater milion e njeqind e katermbedhjetmije e nenteqind e pesedhjete) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë:

Emri Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)

Adresa Rruga "Sami Frashëri", Nr. 8, Tiranë

Tel/Fax 00355 4 232 814

E-mail info@fsdksh.com.al

Adresa e Internetit <http://www.fsdksksh.com.al>

Personi i kontaktit për këtë procedurë prokurimi do të jetë, Z. Arjan Karroci, e-mail: email:arjan.karroci@fsdksh.gov.al ,sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit ligjore nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 7,307,800 (shtate milion e trqind e shtate mije e tetqind), lekë pa TVSH siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08/03/2021

Ankesa: ka ose jo: Nuk Ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

